

UDHËTIM NË FJORDET NORVEGJEZE, 12 – 19 korrik 2024

DITA 1 – TIRANË / OSLO

Mbërritja në aeroport dhe transferimi në hotel me autobusin e organizatorit. Akomodimi në Radisson Blu Scandinavia ose të ngjashëm me të.

DITA 2 - OSLO / GUDBRANDS VALLEY

Mëngjesi në hotel. Takimi me guidën në mëngjes dhe fillimi i turit të qytetit të Oslos me guidën lokale për të zbuluar pikat kryesore turistike. Do të vizitoni Parkun Frogner, ku ndodhen skulpturat kontroverze të Gustav Vigeland. Në fund të vizitës, kohë në dispozicion dhe nisja për në zemër të Norvegjisë me një ndalesë në Lillehammer, një qytet i bukur ku janë zhvilluar Lojërat Olimpike Dimërore të vitit 1994. Mbërritja në zonën e Gudbrandsdalen. **Darka dhe nata në hotel Wadahl Hogfjells ose të ngjashëm me të.**



DITA 3 - GUDBRANDS VALLEY / ÅLESUND

Mëngjesi në hotel. Nisja, përmes peizazheve që të lënë pa frymë, për në qytetin e mrekullueshëm të Ålesund, një qytet i vërtetë muze që ndodhet në ishuj të vegjël, të lidhur me njëri-tjetrin, e ku jetohej me aktivitetin e peshkimit. Mbërritja pasdite dhe kohë e lirë me guidën për të zbuluar këtë xhevahir të Norvegjisë. **Darka dhe fjetja në hotel Quality Waterfront Ålesund ose të ngjashëm.**

DITA 4 - ÅLESUND / FØRDE, NORTH SOGNEFJORD

Mëngjesi në hotel. Në mëngjes nisja për në Hellesylt, pasi të kalohet me traget midis Magerholm dhe Ørneset. Nisja për një lundrim të paharrueshëm me minikroçierë në fjordin Geiranger, një nga më spektakolarët në botë. Mund të admironi ujëvarat e "Vellos së nuses" dhe "Shtatë motrave". Mbërritja në Geiranger dhe vazhdimi nëpërmjet Stryn deri në Skei. Ndalesë në këmbët e akullnajës së mrekullueshme Briksdal. **Darka dhe fjetja në hotel Scandic Sunnfjord ose të ngjashëm.**

DITA 5 - FØRDE / BERGEN

Mëngjesi në hotel. Nisja për në Mannheler dhe kalimi i fjordit deri në Fodnes. Vazhdimi përmes një prej tuneleve më të gjatë në botë, Lærdalstunnelen. Zbritja në Flåm për të eksploruar Nærøyfjord falë një minikroçiere në anije Premium, të gjeneratës së fundit, të cilat përdorin një motor hibrid për të hyrë në pikat më të skajshme dhe spektakolare të fjordit, me respekt maksimal për mjedisin. Mbërritja në fshatin karakteristik Gudvangen dhe vazhdimi për në Bergen, "Perla e Fjordeve", dikur kryeqyteti i Norvegjisë dhe një port i rëndësishëm i Lidhjes Hanseatike (lidhje tregtare mesjetare). Mbërritja dhe vizitë panoramike e qytetit të Bryggen-it, i shpallur si trashëgimi botërore nga UNESCO. Ne rekomandojmë gjithashtu të ngjiteni me teleferik deri në majën e malit Fløyen, për të shijuar një pamje spektakolare panoramike të qytetit. Fjetje në hotel Comfort Hotel Bergen (ish - Comfort Holberg) ose të ngjashëm.

DITA 6 - BERGEN / GEILO AREA

Mëngjesi në hotel. Nisja nëpërmjet Voss për në Bruravik, në brigjet e Hardangerfjord. Kalimi mbi urën Hardanger dhe vazhdimi për në Geilo, një vendpushim i famshëm skish. Ndalesë e shkurtër për të admiruar ujëvarat spektakolare të Vøringfoss. **Darka dhe akomodimi në Geilo Hotel ose të ngjashëm.**

DITA 7 - GEILO AREA / OSLO

Mëngjesi në hotel. Nisja përmes peizazheve mahnitëse të luginave dhe qyteteve të vogla të Norvegjisë. Ndalesa për të parë disa ujëvara dhe bukuri të natyrës. Mbërritja në Oslo. Fjetje në Radisson Blu Scandinavia Oslo ose të ngjashëm.

DITA 8 - OSLO

Mëngjesi në hotel. Sot do të keni mundësinë e një vizite individuale jashtë qytetit. Ecje në këmbë drejt stacionit të trenit për të zbuluar Fredrikstad dhe Gamlebyen, dy qytete interesante të lidhura me njëri-tjetrin, rreth 1 orë me tren nga Oslo. Qyteti i vjetër i Fredrikstad-it në formë ylli u themelua në vitin 1567 dhe është qyteti kala më i ruajtur në Evropën Veriore. Qyteti përcjell një ndjenjë të historisë, një muze i vërtetë në natyrë, ku jetohet dhe punohet. Lagjja është shtëpia e galerive të shumta, artizanëve e dyqaneve, restoranteve dhe kafeneve. Gamlebyen është një tjetër thesar i vërtetë. Në ndërtesat e ruajtura mirë dhe përgjatë rrugëve me kalldrëm do të gjeni një përzierje të jetës së përditshme, artit, historisë, dyqaneve të çuditshme, muzeve, galerive, teatrove dhe kafeneve simpatike. Njerëzit kanë bërë pazar aty që nga 1640! Dyqanet janë të hapura gjatë gjithë vitit, madje edhe të dielave. Ka një treg gjërash të përdorura për fundjavë. Çdo stinë në qendrën historike ka hijeshinë e vet dhe do ta shpërblejë vizitën tuaj.

Nisja drejt aeroportit me autobusin e organizatorit, për fluturimin tuaj të kthimit.

PËRFSHIHEN NË ÇMIM:

- Shoqëruesi në gjuhët italiane/angleze
- 7 prenotime në hotel me mëngjes
- 4 darka në hotel sipas programit
- Minikroçierë në Geirangerfjord: Hellesylt - Geiranger
- Minikroçierë në Nærøyfjord në anijen Premium: Flåm – Gudvangen

FLUTURIMET:

- Tiranë / Oslo 17.35 - 20.55
- Oslo / Tiranë 21.30 - 00.40